


“ MENTI ” SH.P.K. BANJË E PEJËS, ISTOG

**FORMULARI
I KËRKESËS PËR LEJE MJEDISORE**

Shkurt , 2026

SHTOJCA 1

FORMULARI I KËRKESËS PËR LEJE MJEDISORE

Emri i kompanisë	MENTI SHPK
Lloji i veprimtarisë	Bazë Betoni
Emri dhe mbiemri i aplikuesit / Nënshkrimi	Islam Shoshi 
Vendi dhe lokacioni	Corrolluk - Istog
Telefoni , fax , e-mail	044/503-665
Kopje e Vendimit të Pëlqimit Mjedisor	10/2873/1-ZSP-25/11
Kopje e Vendimit të Lejës Mjesore	17/4326/608/DMMU
Certifikatë përdorimi , ose Leje / Licencë për ushtrim të veprimtarisë nga oragani kopetent	KPMM
Deklarimi i vlerës financiare të investimit të projektit (euro)	195.000,00 €
Fatura e pagesës se tarifës për Leje Mjedisore	
Aplikacionin origjinal të plotësuar për Leje Mjedisore në 5 (pesë) kopje fizike dhe një elektronike (CD)	

SHTOJCA 3**Formulari i kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore**

Emri i kompanisë	“Menti” Sh.p.k.
Lloji i veprimtarisë	Bazë për Prodhimin e Betonit
Vendi/Lokacioni ku zhvillon Veprimtarinë	Corrollukë , Istog
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës i kompanisë	Islam Shoshi 
Adresa	Lidhja e Pejës nr. 836
Telefoni, fax, e-mail	044 503-665, mentishpk@gmail.com
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Islam Shoshi
Adresa	Banjë e Pejës, 31010
Telefoni, fax, e-mail	044 503-665, mentishpk@gmail.com
Numri i vendimit të Lejes Mjedisore Paraprake	17/4326/608/DMMU
Përshkrimi i dokumentacionit bashkangjitur kërkesës, përfshirë numrin e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	1. Certifikata e Biznesit NUI 810298556 2. Leja Mjedisore me Nr.17/4326/DMMU dt.18.01.2019 3. Vendimi me nr. 23/6371/MMPHI i dt.30.01.2023 4. Leja Ujore për shfrytëzim të ujit me nr. 594/21 ARPL 09.12.2021 5. Leje Ujore për shkarkim të ujit me nr.593/21/ARPL 09.12.2021 6. Leje për aktivitete të veçanta nr. 959/KPMM/2025 30.12.2025
Fatura e pagesës së tarifës për vazhdimin e Lejes Mjedisore	PO
Pesë (1) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD)	PO

Shtojca 2

Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE

1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME

1.1. Të dhënat për Operatorin


1.1.1.	Emri i subjektit	“MENTI” SH.P.K.
	Vendi	Corrollukë , Istog
	Adresa	Lidhja e Pejes nr. 836
	Nr. i tel./fax	044/503-665
	E-mail	mentishpk@gmail.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	NUI: 810298556 , NRB:70340080 dt. 10.03.2006
1.1.3.	Personi Përgjegjës i kompanisë	Islam Shoshi Përfaqësues i Autorizuar
	Nr. i tel./fax	044/503-665
	E-mail	mentishpk@gmail.com

1.2. Të dhënat për impiantin

1.2.1.	Emri i impiantit	Baze per prodhimin e Betonit
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Corrollukë , Banjë - Istog

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT

2.1. Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur



2.2.	Numri kadastral i parcelës	Lokacioni ku gjendet Fabrika e Betonit është në ngastren kadastrale P-70806056-00217-4 dhe P-70806056-00217-2 , Numri i Certifikates UL-70806056-00476 , në vendin e quajtur Bregu , Zona Kadastrale Carrallukë , Komuna e Istog-ut.
2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë	Lokacioni i Bazës për prodhimin e betonit "Menti"sh.p.k. Carrallukë, Istog me objektet përcjellëse, gjendet në zone të kombinuara biznesore dhe banimore dhe kufizohet si në vijim: Në veri - Parcela e Bazës për prodhimin e betonit "Ment"sh.p.k. kufizohet me vendbanime (shtëpi banimi) që i përkasin fshatit Carralluke. Pamjet në figurën 3, në vijim. Në lindje - Parcela e Bazës për prodhimin e betonit "Ment"sh.p.k. (gjenden objektet administrative) dhe përtej objekteve parcela kufizohet me objekte afariste. Pamjet në figurën 4, në vijim. Në jug - Parcela e Bazës për prodhimin e betonit "Ment"sh.p.k. parcela kufizohet me rrugën magjistrale Mitrovice – Peje. në të cilën ka qasje betonjere. Përtej rrugës, ka hapësira të lira dhe objekte tjera të tipit të kombinuara biznesore/ banimore. Pamjet në figurën 5, në vijim Në perëndim- Parcela e Bazës për prodhimin e betonit "Ment"sh.p.k. kufizohet me një parcelle që është e pronareve të kompanisë me tutje vendbanime (shtëpi banimi) që i përkasin fshatit Carralluke.
2.4.	Të dhënat lidhur me florën dhe faunën në atë lokacion	Bazuar në gjendjen ekzistuese të lokacionit dhe karakterin e zonës ku është planifikuar fabrika e prodhimit të betonit në fshatin Banjë, Komuna e Istogut, nuk evidentohen vlera të veçanta të florës dhe faunës. Zona karakterizohet kryesisht nga sipërfaqe të shfrytëzuara për veprimtari ekonomike dhe toka me përdorim të ndryshuar, ku flora përbëhet nga vegjetacion i zakonshëm, kryesisht barishte spontane dhe bimësi tipike e zonave të hapura rurale. Nuk janë identifikuar specie bimë të mbrojtura, endemike apo me rëndësi të veçantë ekologjike në lokacion apo në afërsinë e drejtpërdrejtë të tij. Sa i përket faunës, prania e saj është e kufizuar dhe përfshin specie të zakonshme të zonave rurale, si shpendë të zakonshëm dhe fauna e vogël që përshtatet me mjediset e transformuara nga aktiviteti njerëzor. Nuk ka të dhëna për habitatë të rëndësishëm natyrorë, korridore ekologjike apo specie të mbrojtura që do të mund të preken nga realizimi i projektit.



		Në përfundim, aktiviteti i planifikuar nuk parashikohet të ketë ndikim të rëndësishëm në florën dhe faunën e zonës, pasi lokacioni nuk përfaqëson një mjedis natyror të ndjeshëm apo me vlera të veçanta ekologjike.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtura	Bazuar në të dhënat në dispozicion dhe analizën e lokacionit, në zonën ku është planifikuar fabrika e prodhimit të betonit në fshatin Banjë, Komuna e Istogut, si dhe në afërsinë e drejtpërdrejtë të saj, nuk evidentohen zona të veçanta të mbrojtura. Në këtë hapësirë nuk ka parqe kombëtare, rezervate natyrore, zona të mbrojtura të biodiversitetit apo zona me status të veçantë mbrojtjeje sipas legjislacionit në fuqi.

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore

3.1.1.

Skema e procesit
teknologjik



3.1.2.	Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik	Baza për prodhimin e betonit perbehet prej ketyre objekteve dhe paisjeve. Baza për prodhimin e betonit përbehet prej këtyre objekteve dhe pajisjeve: - Objekti i administratës ne dy etazha - Siloset për çimento 2x100 ton - Pajisjet për përzierje te betonit – mikseri sipas fraksioneve me kapacitet 60-80 m³/orë ne kohë reale , ndersa teorik 120 m³/orë prodhim Turkie viti 2022 - Kompresori për furnizim me ajër - Katër siloset 4x25 m³ – bunkerat per deponim te zhavorit - Peshorja automatike - Mekanizmi për furnizim me agregat (ena) - Gjeneratori për furnizim me rrymë - Deponija - platoja për fraksionet e agregatit - Objektet e fabrikës se betonit, garazha dhe objekte tjera ndihmese, - Objektet e fabrikës se betonit janë objekte përdhese dhe si te tilla janë ne funksion te pajimeve për prodhimin e betonit. Betoni paraqet konglomerat qe përfitohet ma përzierjen e çimentos, fraksioneve të rërës/gurit dhe ujit. Me programin e prodhimit parashihet prodhimi i këtyre llojeve të betonit: - Betonet plastike 0-16 (C-12/ 15, C-15/20, C-20/25 , C-25/30, C-30/37, C-40/45) - Betonet plastike 0-31.5(C8/10, C-12/ 15, C-15/20, C-20/25 , C-25/30, C-30/37, C-40/45) - Beton i ajruar 0-16 (C-15/20, C-20/25 , C-25/30, C-30/37, C-40/45) - Beton i ajruar 0-31.5 (C-15/20, C-20/25 , C-25/30, C-30/37, C-40/45) - Beton i qëndrueshëm ndaj ujit 0-16 (C-15/20, C-20/25 , C-25/30, C-30/37) - Beton i qëndrueshëm ndaj ujit 0-31.5 (C-15/20, C-20/25 , C-
--------	--	---

25/30, C-30/37)

- Përpos këtyre llojeve të betoneve mund të prodhohen edhe lloje të veçanta të betoneve: për ndërtimin e rrugëve, ujërave, tuneleve, për konstruksione nën ujë etj. Si dhe për prodhimet e të gjitha llojeve të produkteve nga betoni që janë: kubëzat e të gjitha formave dhe me dimensione të ndryshme, bllokat me madhësi të ndryshme, gypat me madhësi të ndryshëm, në baze të kërkesave të blerëseve.

- 4.2.Komponentët në procesin e prodhimit të betonit

- Çimentoja-paraqet komponentin lidhës të betonit. Sipas teknologjisë për prodhimin e betonit në betonierë do të përdoret çimentoja portllant.

- Në raste të veçanta varësisht prej llojit të prodhimit të betoneve, përdoret çimentoja speciale. Cilësia e çimentos përcaktohet në bazë të aftësisë lidhëse të shprehur nëpërmjet fortësisë: 200, 320, 500, 600, dhe 800 kp/cm².

- Çimentoja portllant nuk duhet të ketë force në shtypje më të vogël se 320 kp/cm².

- Sasia për prodhimin e betonit, përkatësisht shpenzimi specifik i çimentos është 200-400 kg/m³.

- Agregati –guri ose rëra. do të furnizohet me agregat nga gurethyes apo edhe nga seperacionet e tjera,agregati duhet të përbush kushtet e parapara në pikëpamje të cilësisë dhe granulacionit.

- -Agregati duhet të jetë pa asnjë shtesë të cilat reagojnë me ujin dhe shkaktojnë shkapërderdhje, kloriket, sulfatet dhe kompozimet tjera kimike që i dëmtojnë vetitë fiziko mekanike të betonit dhe nuk guxojnë të jene të pranishme.

- Materiet organike dhe humusi pengojnë ngurtësimin e çimentos në beton. Preferohet që raporti i agregatit në beton të jetë: 1:2 – 1:7, varësisht prej llojit të betonit që prodhohet.

- Uji - është komponentë i rëndësishëm për lidhje gjatë prodhimit të betonit. Çështjen e ujit pronari e ka zgjidh me anë të pusit i cili është i hapur në afërsi të betonierës dhe me anë të pompave e mbushë rezervarin e ujit i cili shërben për të marrë ujë rezervë për

nevojat e bazës së betonit.

- Në procesin e prodhimit të betonit duhet të përdorët vetëm uji i pastër , ujë i cili nuk përmban materie organike qe formohen nga bimët e kalbura.
- Harxhimi i ujit për procesin teknologjik për prodhimin e betonit varet nga lloji i betonit që dëshirojmë të e prodhojmë.
- Në vijim do të ipet përqindja e ujit në beton në varësi nga lloji i betonit:
- Për beton të lëngshëm 6 - 8 %
- Për beton plastik 7 - 9%
- Për beton të fortë plastik 8 - 10%
- Siç kemi cekur në pasuset e më sipërme në këtë betonierë mund të prodhojmë beton të kualiteteve të ndryshme duke u bazuar në destinimin e tyre dhe atë sipas nevojës dhe kërkesave të hargjuesve të betonit.

Agregati/Fraksionet	- 0- 4mm	- +4- 8mm	- +8- 16 mm	- Gjithsejtë
Përqindja	- 45%	- 20%	- 35%	-
Sasia	- 824 kg	- 366 kg	- 642 kg	- 1832 kg
Çimentoja	-	-	-	- 350 kg
Uji	-	-	-	- 238 kg

- Në tabelën e mëposhtme do të japim një shembull që paraqet sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë pa fraksionin +16-31.8 mm, sasinë e çimentos dhe sasinë që nevojitet për prodhimin e 1 m³ beton C-30/37 sipas recepturës së caktuar:

- Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci material për prodhimin e 1 m³ beton që shihet në tabelën e më poshtme:

- Hyrja		- Dalja	
- Agregati	- 1890 kg	- 1 m ³ beton	- 2440 kg
- Çimentoja	- 350kg	-	-
- Uji	- 200 kg	-	-
- Bilanci i përgjithshëm	- 2440 kg	-	- 2440 kg

- Agregati	- 1890 kg	- 1 m ³ beton	- 2430 kg
- Çimentoja	- 320kg	-	-
- Uji	- 220 kg	-	-
- Bilanci i përgjithshëm	- 2430 kg	-	- 2430 kg

Përshkrimi i procesit teknologjik të prodhimit të betonit

- Prodhimi i betonit në betonier fillon me përgatitjen e lëndëve të para: agregatit (fraksioneve të gurit apo fraksioneve të rrërës), çimentos dhe ujit.

- Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, fillon me mbushjen e siloseve me rrërë apo gurë me granulacione të ndryshme në varësi të markës së betonit që dëshirohet të prodhohet, siloset pranues me fraksione të gurit ose rrërës mbushet me anën e lopatë ngarkuese nga depoja e fraksioneve të agregatit, katër siloset e gurit ose rrërës, janë të ndara njëra prej tjetrit me mure të pllakave të çelikut.

- Proces tjetër paraqitet mbushja e silosit më çimento të tipit të caktuar, mbushja bëhet me anë të autocisternave me **proces** pneumatik.

- Në procesin teknologjik bëjnë pjesë edhe sistemi i pajisjeve për furnizim me ujë, pompave hidraulike, pneumatikës, pajimeve elektrike dhe automatike në veçanti.

- Agregati nga siloset ku në dalje të cilëve ndodhën pozuesit elektro-pneumatik të cilët më dhënien e komandës nga tabela komandues hapen dhe mbyllën në mënyrë automatike pasi të e lëshojë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues i cili gjendet nën siloset e agregatit i cili e transporton granulacionet(fraksionet) e agregatit deri në skipin-enën e cila nevojitet për bartje e fraksioneve të agregatit deri në mikser(përzierësen) për prodhimin e betonit. Në pozuesit e fraksioneve

më të imta janë të vendosur vibratorët më qëllim të rrjedhjes së fraksioneve sa më lehtë në enën e agregatit, transportier e pastaj nga transportieri shiritor në enën prej nga dërgohet në mikser.

- Dozimi i çimentos në përzierëse bëhet nëpërmes transportuesit kërmillor nga silosi. Çimentoja me ramje të lirë bjen në transportuesin të vendosur nënë silos, pastaj nëpërmjet transportuesit kërmillor dozohet në enën e peshojës për çimento. Zbrazja e enës së peshojës kryhet në mënyrë të programuar dhe atë në kohën e dozimit të agregatit në mikser, ashtu që zbrazja e pajisjes të çimentos në mikser fillon automatikisht në momentin e dozimit të agregatit nga mikseri apo disa sekonda më vonë. Gjatë kohës së zbrazjes së enës së peshojës me çimento duhet të lëshohet edhe vibruesi në mënyrë automatike.

- Dozimi i ujit në përzierëse si lëndë bazë për përfitimin e betonit bëhet me dozimin e programuar nga pompa e posaçme e cila punon në mënyrë automatike me fillimin e dozimit të çimentos. Pas dozimit të sasisë së caktuar të ujit, ventili pozues automatikisht mbyllet. Nëse janë përmbushë kushtet e procesit për punë automatike (sasia e nevojshme e agregatit në fortin, shtypja e ujit duhet të jetë min. 3 atm. Dhe sasia e nevojshme e çimentos), sasia e prodhuar e betonit për një cikël është 1 m^3 , zgjatja e një cikli është përafërsisht 60 sec. Në varshmëri të llojit të betonit. Gjatë kryerjes së procesit në mënyrë manuale koha e ciklit varët nga aftësia e punëtorit që operon me pajisjet për kryerjen e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.

- Para se të lëshohen pajisjet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit duhet të kryhen këto veprime:

- Duhet sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silos

- Duhet sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur vetëm ventilin e silosit nga i cili do të marrim çimento

- Duhet sigurohet sasia e mjaftueshme e ujit

- Duhet caktuar recepturën për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë të e prodhojmë

- Të caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar.

	- Pajisjet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar dhe në mënyrë manuale. Menaxhimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit, kryhet nga pulti komandues i automatizuar dhe i vendosur në dhomën e caktuar për te. - Modulet hyrëse drejtpërdrejtë pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshojat, nëpërmjet sondave për te gjithë komponentët e procesit të prodhimit. - Modulet digjitale dalëse shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetikë motorëve si dhe llambave sinjalizuese. - Menaxhimi i procesit behet edhe përmes disa monitorëve të vendosur në panelin e komandimit, përmes këtij paneli operatorit i mundësohet mbikqyerja e procesit të prodhimit dhe recepturat për prodhimin e betonit, me këtë mundësohet matja më e lehtë e komponentëve të agregatit dhe komponentëve tjerë shtese. - Për të arritur cilësinë e duhur të betonit behet sitja e çimentos me sita standarde dhe përcaktohet kohe lidhja e saj. (Kohe lidhja e çimentos paraqet kohën nga momenti i përzierjes së çimentos me ujë deri në momentin e fillimit të hidratimit të saj dhe arritjen e fortësisë përkatëse). Përpos komponentëve të lartcekura për të arritur veti specifike të betonit duhet shtuar edhe aditivët. Në sezonin e dimrit dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditivë të cilët e shpejtojnë kohën e ngurtësimit. Aditivi shtohet me ujë ose drejtë për drejtë në mikser. - Dozimi i aditivit behet prej 2-4 % të masës së çimentos. Për realizimin e procesit të prodhimit të betonit, me energji elektrike furnizohet nga rrjeti elektrik nëpërmjet trafos, ndërsa në mungesë të energjisë elektrike kompania posedon gjeneratorin për mbarëvajtjen e procesit teknologjik. - Përveç pajisjeve të lartcekura për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit dhe për bartjen e tij gjër te hargjuesi (konsumatori) kompania dispon me mekanizëm: automikserë, autocisternë për bartjen e çimentos, pompë të betonit (60 m³/h), dhe pesë kamionë për bartjen fraksioneve të agregatit dhe dy lopata ngarkuese. Bazuar në kërkesat dhe përvojën e punës në këtë betonier, punët do të
--	---

		organizohen vetëm në ndërrim të parë. Fuqia punëtore e angazhuar është e konsiderueshme dhe do të ketë ndikim pozitiv në punësimin e popullatës.
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	Punimi i betonit behet sipas kërkesa të klienteve , se pari sigurohet se klienti është i gatshëm ta pranojë produktin pastaj fillon procesi i prodhimit , Numri i oreve gjatë ditës dhe javës variron , ndërsa orari i rregullt i punës është 8:00 deri në orën 16:00
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Kapaciteti i projektuar është 120 m³/h , ndërsa kapaciteti i realizuar 60-80m³/h Kapaciteti ditor: 480 m ³ /ditë Kapaciteti Mujor: 12,000.0 m ³ /muaj Kapaciteti Vjetor: 120,000.0 m ³ /Vit
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës së parë dhe lendeve ndihmëse.	Lenda e parë furnizohet nga pala e tretë , pra nga furnitore të licencuar sipas zhavorit në fraksione , Çimento , Nafta , Energjia elektrike nga KEDS-i ndërsa uji kemi pusin e hapur brenda hapsirave të objektit
3.1.6.	Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre	Kompania i ka hequr të gjithë rezervuarët nuk posedon rezervuar për deponimin e naftës.
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	Lista e Ligjeve dhe rregulloreve, Për plotësimin e formularit për vazhdimin e Lejes Mjedisore për kompaninë “Menti” SH.P.K. : Ligjet • Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 • Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 • Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-160 • Ligji për VNM Nr. 08/L181 • Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102 • Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 02/L-41 • Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174 • Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110 • Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr.03/L-233 • Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147

		Udhëzimet Administrative • Udhëzimi Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI - Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, • Udhëzim Administrativ nr.04/2022 për Leje Mjedisore • Udhëzimit Administrativ nr. 06/2007 mbi rregullat dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes.
--	--	--

3.2. Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit

3.2.1	Sistemi menaxhues i mbrojtjes së Mjedisit	Kompania “Menti” Sh.P.K Banjë e Pejës, Istog, Bazë për prodhimin e betonit është e përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në ISO 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizate me synim: • Parandalimin e dëmtimit të mjedisit • Përmirësimin e vazhdueshëm i mjedisit • Respektimin e legjislacionit vendor Përmirësimin e komunikimit me autoritete
3.2.2	Raportimi	Raportime se paku ne fund te qdo viti kalendarik nga Ekspertet e kompanisë tek autoritetet perkatese

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

4.1.	Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse	→ Pluhurat të cilët lirohen nga automjetet e transportit dhe ngarkimit të betonit → Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operationale që ndodhën në afërsi të bazës së betonit. → Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e transportit dhe ngarkimit të betonit. → Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të betonit. → Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të betonit nga silosi në automikser.
4.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Ndikimi i emisionit të materieve ndotëse në kualitetin e ajrit varet para se gjithash nga kushtet klimatike – meteorologjike dhe numri i automjetet transportuese që transportojnë fraksionet të materialit. Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër, gjatë funksionimit të gurthyesit kompania ka marrë këto masa: - Spërkatja e rrugëve në temperatura të larta, - Përdorimi i makinerive të reja të cilat nuk lirojnë gazra të ndotura.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse paraqiten nga pluhurat të cilët lirohen nga qarkullimi i automjeteve brenda dhe jashtë Kompanisë “Menti” Sh.P.K Banjë e Pejës, Istog, Bazë për prodhimin e betonit. Pluhurat të cilët lirohen nga deponit të cilat nevojiten për deponimin e fraksioneve të agregatit, nga mundësia lirim të pluhurit nga sipërfaqet manipuluese, Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të betonit. Pluhurat të cilët lirohen gjatë transportit të betonit nga silosi në autocisternë.
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit të betonit duhet të menjahet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin. Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër,

		gjatë procesit teknologjik të bazës së betonit përpos masave të lartë cekura duhet ndërmarr edhe këto masa: • Duhet të bëhet mirëmbajtja e rregullt e pajimeve për prodhimin e betonit e posaçërisht stabilimenteve të cilat janë burim i emisioneve të pluhurit. • Duhet të bëhet kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve të rënda dhe konsumuesve tjerë të lëndëve të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga mjetet e punës të jetë samë kualitativ. • Gjithmonë duhet të bëhet spërkatja e sipërfaqeve manipuluese, rrugëve transportuese fraksioneve, sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta. • Duhet çdo herë të ketë ujë rezervë për spërkatje. • Per menjanimin dhe zvoglimin e sasis së pluhurit kompania duhet të instaloj sistemin e fitrave me thas ne siloset qe perdoren për deponimin e qimentos. • Te gjith gypat qe nevojiten per mbushjen e siloseve me qimento si dhe gypat te cilet e furnizojn mikserin me qimento duhen rregullisht te kontrollohen pjeset lidhese te tyre te mbyllen hermetikisht me mbyllje adekuate. Thaset e filtrave te kontrollohen rregullisht dhe nese demtohen ato duhen te ndrrohen. • Duhet të bëhet matja e imisioneve të pluhurit gjatë punës bazës së betonit dhe në territorin më të gjer, duke iu përmbajtur të gjitha masave të cekura më lartë për mbrojtjen e ajrit, me qëllim të caktimit të sasisë së pluhurit, dhe për të kragasuar vlerat e matura më vlerat kufitare të caktuara.
4.5.	Pajisjet për de-pluhurim	Nuk janë te nevojshm,
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Kompania e bën monitorimi i emisioneve siç kërkohet ne Leje Mjedisore.
4.7.	Monitorimi i Emisioneve /cilësisë së ajrit	Kompania e bën kontroll dhe matjet e emisioneve në ajër ashtu siç kërkohet
4.8.	Raportimet	Raportimi behet ne MMPHI

4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Për ta parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat i kemi cekur më lart, kompania ka marrë të gjitha masat duke - rrugët ku behet transportimi I masës shkëmbore vazhdimisht spërkatet me ujë. - Behët kontrollimi i rregullt teknik i makinave që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që emetimi i gazrave nga automjetet e punës të jetë sa më kualitativ. - E gjithë hapësira e kompleksit spërkatet me ujë posaçërisht në kohëra me erëra dhe temperatura të larta.
4.10	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Fabrika e prodhimit të betonit e kompanisë “Menti” SH.P.K., e planifikuar në fshatin Banjë, Komuna e Istogut, do të zbatojë masa konkrete për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike, kryesisht përmes uljes së emetimeve të gazrave serrë dhe rritjes së efijencës së burimeve. Gjatë fazës së operimit, do të përdoren pajisje dhe makineri bashkëkohore me konsum të ulët të energjisë dhe efikasitet më të lartë në procesin e përzierjes dhe ngarkimit të betonit. Mirëmbajtja e rregullt e impiantit dhe mjeteve transportuese do të sigurojë djegie më të pastër të karburanteve dhe ulje të emetimeve të CO₂. Do të optimizohet organizimi i transportit të lëndëve të para dhe i shpërndarjes së betonit, në mënyrë që të reduktohet numri i lëvizjeve të panevojshme dhe distancat e përshkuara nga automjetet. Kjo masë ndikon drejtpërdrejt në uljen e konsumit të karburanteve fosile dhe të emetimeve përkatëse. Fabrika do të aplikojë përdorimin racional të energjisë elektrike, duke shfrytëzuar pajisje ndriçimi me efikasitet të lartë dhe, kur është e mundur, automatizim të proceseve për të shmangur humbjet energjetike. Po ashtu, do të shqyrtohet mundësia e integritit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë për nevojat ndihmëse të objektit. Si masë shtesë, do të promovohet përdorimi i lëndëve të para nga burime sa më afër lokacionit, me qëllim uljen e gjurmës së karbonit të lidhur me transportin. Gjithashtu, menaxhimi i mbetjeve të prodhimit dhe rikthimi i betonit të pashfrytëzuar në proces do të kontribuojë në reduktimin e emetimeve indirekte. Zbatimi i këtyre masave siguron që

		aktiviteti i fabrikës së betonit të zhvillohet me ndikim sa më të ulët në ndryshimet klimatike, duke respektuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit.
--	--	--

5. UJI

5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Kompania “Menti” SH.P.K. furnizohet me ujë për nevojat e fabrikës së prodhimit të betonit nga pus nëntokësor i ndërtuar brenda lokacionit. Shfrytëzimi i ujit realizohet në bazë të lejes ujore të vlefshme, të lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ujërat. Uji i marrë nga pusi përdoret kryesisht për procesin e prodhimit të betonit dhe për nevoja teknike ndihmëse, ndërsa shfrytëzimi bëhet në sasi të kontrolluara, pa tejkaluar kapacitetin e lejuar sipas lejes ujore. Ky furnizim nuk parashikohet të ketë ndikim negativ në burimet ujore përreth, pasi shfrytëzimi është i rregulluar dhe i monitoruar.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet e ujërave sipërfaqësore apo në rrjetin e kanalizimit	Shkarkimi i ujërave në kuadër të fabrikës së prodhimit të betonit të kompanisë “Menti” SH.P.K. realizohet në mënyrë të kontrolluar dhe të ndarë sipas burimit të tyre. Ujërat që rezultojnë nga pastrimi i makinerive dhe pajisjeve të prodhimit grumbullohen dhe trajtohen në sedimentues të dedikuar, ku realizohet ndarja e materialeve të ngurta përpara çdo shkarkimi, duke parandaluar ndotjen e mjedisit. Ujërat e ndotura sanitare që burojnë nga zyret dhe hapësirat administrative shkarkohen në rrjetin ekzistues të kanalizimit të fshatit, në përputhje me rregulloret komunale në fuqi. Ky sistem siguron që shkarkimi i ujërave të kryhet pa ndikime të dëmshme në ujërat sipërfaqësore dhe mjedisin përreth.

5.3.	Ndikimet në ujë	Derdhja eventuale e derivateve si nafta, vajrat e ndryshme mund të dikojnë në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Në kompaninë "MENTI " SH.P.K., Fabrike per prodhimin e betoni , nuk gjeneron ndotje rrezik të ujërave sipërfaqësore, e pastaj edhe të ujërave nëntokësore, pasi që ndërrimin e vajrave nuk e bënë brenda kompleksit por në autoservis andaj edhe nuk ka emisione të ujërave të ndotura.
5.5	Trajtimi i ujërave të ndotura	Trajtimi i ujerave te ndotura nga pastrimi i makinerive behet ne sedimentues ndersa ujerat nga zyret shkarkohen direkt ne rrjetin e fshatit.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Per ujerat e shkarkuara nga pastrimi i makinerive behen analizat e ujerave te ndotura
5.7.	Raportimi	Raportimi behet ne ARPL/MMPHI
5.8.	Leje Ujore për shfrytëzim të ujit	Kompania ka Leje Ujore per shfrytezim te ujit
5.9.	Leje Ujore për shkarkimin e ujërave	Kompania ka Leje Ujore per shkarkim te ujit
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Trajtimi i mbeturinave komunale mos te hidhen ne vende te pa caktuara dhe ndërrimi i vajit për makineritë duhet te behet ne servise adekuate.

6. ZHURMA

6.1.	Burimet	Ndikimet nga Zhurma: Zhurma, si element në kompleksin “Menti” Sh.P.K Banjë e Pejës, Istog, paraqet një faktor me rëndësi hapësinore e cila ka ndikim të madh në dëmtimin e të dëgjuarit, në sistemin nervor, në hipertension, në koncentrim e njeriut në punë etj. Zhurma, si element në teknologjinë e prodhimit ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banurara. Zhurma vije si rezultat i aktivitetet prodhuese kryesisht nga makinat gjatë procesit të ngarkimit, dhe transportit të betonit, gjeneratorit. Me shfrytëzimin e pajisjeve prodhuese në bazë të standardevetë zakonshme maksimumi i zhurmës në burim është 90 dB. Zhurma për zonën e banuar është plotësisht në kufijtë e standardit dhe gjatë ditës nuk kalon 50 dB, kurse gjatë natës rrallë punohet, por edhe kur punohet nuk është më e madhe se 45 dB. Ne vijim po e paraqesim ne formë tabelare nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca. <table><tr><th rowspan="2">Zhurma</th><th colspan="4">Distanca (m)</th></tr><tr><th>10</th><th>50</th><th>100</th><th>500</th></tr><tr><td>90 db-niveli për pajisje moderne</td><td>59</td><td>45</td><td>39</td><td>25</td></tr></table> Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë dhe duke pasur parasysh distancën e ndërtesave të banimit si dhe kapacitetin e pajimeve dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojiten për realizimin e procesit të prodhimit të betonit mund të konkludojm se ne aspektin e zhurmës nuk do të ketë ndikime negative të mëdha në njerëzit që banojnë dhe veprojnë në këtë lokalitet.	Zhurma	Distanca (m)				10	50	100	500	90 db-niveli për pajisje moderne	59	45	39	25
Zhurma	Distanca (m)															
	10	50	100	500												
90 db-niveli për pajisje moderne	59	45	39	25												
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Si pasojë e lëvizjes së automjeteve, bagerave, autocisternave mund të v’ie deri te ngritja e zhurmës ne përmasa te lejuara. Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.														
6.3.	Raportimet	Nuk behet raportimi i zhurmës vetem nese kerkohet me leje mjedisore														

7. TOKA

7.1.	Ndikimet në tokë	Gjatë fazes së ndërtimit të Kompanisë “Menti” Sh.P.K Banjë e Pejës, Istog, ndikim negativ në toke janë paraqitur në aspektin e degradimit të sipërfaqes së tokës, prishja e pejsazhit, ndikim negativ në toke paraqitet nga mbeturinat e ngurta, ndotja e dheut është si pasojë e sedimentimit të ndotjeve që sjellin përmes ujërave sipërfaqësore që vijnë nga sipërfaqet e kompleksit të Kompanisë “Menti” Sh.P.K Banjë e Pejës, Istog, dhe nga fundrrimet e komponenteve ndotëse nga ajri. Pas përfundimit dhe rehabilitimit të vendit nuk ka pasur ndikime tjera në tokë. Ndikimet mund të vijnë po ashtu edhe nga Ndotja aksidentale e dheut e cila vije si pasojë e avarive të ndryshme në Impiant të cilat deri më tani nuk ka ndodhur asnjëherë.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë duhet marrë këto masa mbrojtëse: - Të gjitha mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontinjer të posaçëm të pajisur me kapak për mbledhje, me transport vetanë apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deoninë e qytetit.
7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Pas përfundimit të aktivitetit të prodhimit të betonit nga kompania “Menti” SH.P.K. në Banjë të Istogut, do të ndërmerren masa rehabilituese me qëllim rikthimin e tokës në gjendje sa më të përafërt me ambientin përreth. Kohëzgjatja e aktivitetit varet nga vjetërsia e pajisjeve dhe vendimi i pronarit për vazhdimin ose përfundimin e veprimtarisë. Me përfundimin e aktivitetit, pajisjet e betonierës do të çmontohen dhe, sipas leverdisë ekonomike, do të shiten si material i vjetruar. Bazamentet dhe platot e betonit do të shkatërrohen, imtësohen dhe dërgohen në deoninë përkatëse. Substratet e dëmtuara dhe materialet sterile nga procesi teknologjik do të largohen dhe do të zëvendësohen me shtresë humusi për të krijuar një tokë të qëndrueshme dhe produktive. Rikultivimi do të realizohet në disa faza. Fillimisht do të kryhet rikultivimi teknik, duke formuar një profil të ri të tokës me shtresë dheu prej rreth 30–50 cm. Më pas do të vazhdohet me rikultivimin agroteknik, përmes analizës së tokës dhe aplikimit të masave përmirësuese. Në fazën

		përfundimtare, rikultivimi biologjik do të realizohet përmes mbjelljes së kulturave bujqësore periodike dhe fidanëve frytdhënës, në përputhje me karakterin bujqësor të zonës. Zbatimi i këtyre masave synon rivitalizimin e plotë të sipërfaqeve të dëmtuara dhe uljen e ndikimeve negative të projektit në mjedis, duke krijuar kushte për përdorim të qëndrueshëm të tokës në të ardhmen.
--	--	--

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1.	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	Llojet e Mbeturinave janë: Gjatë zhvillimit të veprimtarisë në bazën për prodhimin e betonit të kompanisë “MENTI” SH.P.K., përveç mbeturinave komunale, nuk gjenerohen lloje të tjera të mbeturinave. Procesi teknologjik i prodhimit të betonit nuk krijon mbeturina industriale apo të rrezikshme. Mbeturinat komunale që gjenerohen lidhen me aktivitetet e përditshme të punonjësve dhe përfshijnë kryesisht mbetje ushqimore, ambalazhe letre dhe kartoni, plastike dhe mbetje të ngjashme. Këto mbeturina klasifikohen sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave me kodin 20 03 01 – Mbeturina komunale të përziera. Grumbullimi dhe largimi i mbeturinave komunale bëhet përmes operatorit të autorizuar nga komuna, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e mbeturinave.
8.2.	Përshkrimi i Magazinimit apo deponimit të mbeturinave	Gjatë aktivitetit të Kompanisë vetëm mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen, klasifikohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim.
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklim të mbeturinave	Gjatë aktivitetit të Kompanisë nuk bëhet përpunim dhe riciklim i mbeturinave.
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër – kontrate me kompaninë me leje përkatëse	Nuk kemi mbeturina të cilat duhet të dërgohen për trajtim apo riciklim tek operatorët tjerë.

8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Kompania nuk ka hartuar Planin për menaxhimit me mbeturina,
8.6.	Raportimi	Nuk behet raportimi

9. RREZIKU NGA AKSIDENTET

9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve ne rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Plani i mbrendshem do të përmbanë Objektivat e Planit: • Parandalimi i zjarreve. • Mbrojtja dhe ruajtja e pasurisë dhe të mirave materiale. • Ruajtja dhe mbrojtja e Mjedisit. • Vlerësimi i rrezikut. • Mbrojtja e jetës dhe shëndetit të jerëzve. Qëllimi i planit: Qëllimi i hartimit të këtij Plani është krijimi i prioriteteve për një koordinim sa më efikas në mes të subjekteve relevante të cilat janë përgjegjëse që të veprojnë shpejtë dhe me efikasitet në rastet e fatkeqësive – zjarreve. Zvogëlimi të rrezikut, gadishmerija për të mare vendime të duhura dhe kthimin e shpejtë të shoqërisë në jetën normale. Kordinim i veprimeve (në raste të zjarreve përmasash të mëdha) Plani i jashtem: Qellimet kryesore te ketij Plani jane: • Të shmange efektet serioze (si p.sh. vdekjte nga aksidentet). • Të zvogeloe rrezikun e ndodhjes se aksidenteve dhe/ose te zbusse pasojat e aksidenteve kur ata ndodhin. • Të terheq vemendjen e përdoruesve dhe të autoriteteve përkatëse ndaj mundesise se ndodhjes te nje aksidenti dhe ndaj zbatimit te masave te nevojshme per shmangien e tij. Për realizimin e objektivat të më sipërme, ky plan përmban këto çështje: • Ekipet e mergjencave dhe pergjegjesit e tyre. • Trajnimi i puntorëve. • Pergjegjesite organizative dhe funksionale • Kushtet e emergjencave dhe veprimet mbrojtese.
------	--	--

9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Kompania nuk përdorë substanca të rrezikshme kimike dhe preparate.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Masat që duhet të merren në raste aksidenti • Të merren masat për evidentimin e derdhjeve të derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese. • Pronari është i detyruar të mbanë evidencën dhe ruan shënimet për dërgimin e tyre në qendrat e licensuara për riciklim, për sasinë dhe llojin e mbetjeve nga mbeturinat, me qëllim që të vërtetohet dalja e mbeturinave në këtë lokacion (vendi për grumbullimin e mbeturinave). • Evidenca dhe shënimet duhet të mbahen sipas rekomandimeve që jepen në Ligjin për Mbeturina Nr. 02/L-30 dhe Udhëzimeve administrative për mbeturina të hartuara sipas rekomandimeve nga Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 • Në mënyrë permanente të mirëmbahet ambienti në kompleksin e “Menti” Sh.P.K Banjë e Pejës, Istog. • E tërë sipërfaqja e kompleksin e “Menti” Sh.P.K Banjë e Pejës, Istog, duhet të rrethohet. • Në rastet kur kemi rrjedhje të vajrave dhe fluideve si mbeturina specifike që mundë të ndodhin gjatë procesit, atëherë lëngu i derdhur duhet të pastrohet me absorbues kimik të cilat me lopata mblidhen dhe futen në fuqi ku mbahen në depo derisa të merren nga kompanitë e licensuara për trajtimin e tyre.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kompania nuk e ka hartuar Raportin mbi gjendjen e sigurisë.

10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT

10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Nuk ka nderprerje momentale
10.2.	Ndërprerja e punës	NUK Ka nderprerje te punes.

11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHËNDETIN E NJERIUT

Ndikimi i mundshëm i ndotjes në shëndetin e njeriut:

Nga analiza e veprimtarisë së planifikuar dhe kushteve të lokacionit, konstatohet se nuk ka pasur ndikim në shëndetin e njeriut. Procesi i prodhimit nuk përfshin përdorimin e substancave të rrezikshme dhe nuk gjeneron emetime të tilla që do të mund të rrezikonin shëndetin e punonjësve apo të banorëve përreth.

Masat standarde të punës dhe organizimi i aktivitetit brenda impiantit sigurojnë që çdo ndikim potencial të mbetet brenda kufijve të lejuar ligjorë. Zona përreth nuk ka dendësi të lartë banimi, ndërsa aktiviteti zhvillohet në përputhje me praktikën e zakonshme të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë.


Bazuar në këto kushte, vlerësohet se aktiviteti i fabrikës së prodhimit të betonit nuk paraqet rrezik për shëndetin e njeriut.

Personi Përgjegjës për Mjedis

Emri Mbiemri

Islam Shoshi

Nënshkrimi



Personi përgjegjës i Kompanisë

Emri Mbiemri

Islam Shoshi

Nënshkrimi

